

## Procesverbal

Nga seanca e IV-të(katërtë)/2019 e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 03.05.2019, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

### Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e III-të/2019 e KK-së Dragash.,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për realizimin e buxhetit, për periudhën Janar-Mars/2019...,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Rregullores për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në Komunën e Dragashit...,
4. Shqyrtimi i Kërkesë së delegatit Sefidin Mejzini, për fushë sportive në "Mejdan"..., dhe
5. Eventuale...

Seancën, me përvetësimet e tē pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së Dragash z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarimin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësimë të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...?

z.Nexhat Isufi- Unë dëshiroj që, në kuadër të pikave të rendit të ditës, të shtohet edhe një pikë tjetër e cila do të ishte "Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve", pasi se Komuna e jonë nuk ka Komision të tillë e që do të ishte e drejtë dhe e arsyeshme që edhe ne t'a kishim Komisionin e tillë?

z.Zinaida Elmazi- Unë, dje në KPFinanca, kam propozuar një çështje të cilën e kam propozuar edhe më herët, që kam kërkuar, nga kryetari dhe kryesuesi i Kuvendit, që të caktojnë një seancë të jashtëzakonëshme lidhur me deponitë ilegale-komunale, përkatësisht për deponitë e ngurta ilegale. Pasi se jam anëtarë e Akademisë së EDA-së, e cila është e interesuar që të merr pjesë në një seancë të tillë, ndoshta, kanë edhe ndonjë projekt se si të pastrohen deponitë e tillë ilegale, që kërkoj nga kolegët të përkrahin iniciativën e këtillë.

Kryesuesi- A ka mundësi edhe një herë të sqarohet çështja e atij Komisioni z.Nexha I.?

z.Nexhat Isufi- Po, lidhur me këtë çështjen e këtij Komisioni, po theksoj se sipas Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike, sa i përket Bordit të Drejtorëve, mbikqyrjen dhe raportimin e bënë ky Komision i cili zgjedhet nga ana e 2 delegatëve të Kuvendit dhe anëtarëve të pushtetit ekzekutiv. Qëllimi i këtij Komisioni është që ndërmarrjet publike, ato rajonale e lokale, të bëjnë zgjedhjen e anëtarëve të vetë të Bordit i cili do të përfaqëson kompaninë në niveli lokal dhe rajonal. Të gjitha komunat kanë komisone të tillë, dhe pse, edhe komuna jonë, mos të ketë një Komision të tillë?

z.Zaim Hajredini- Unë, në radhë të parë, kërkoj që të miratojmë rendin e ditës e pastaj të lëshohemi në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës?

Kryesuesi- Kalojmë në miratimin e rendit të ditës.

z.Zinaida Elmazi- Kërkoj që propozimet tonë që i dham të vihen në votim, si dhe kërkoj më shumë seriozitet. Ne këtu, po kërkojmë që komuna jonë të jetë destinacion turistik dhe, z.kryetar e kryesues, ne

nuk duhet tē qëndrojmë vetëm nē zyre dhe, ju kisha lutar që tē shëtitni pak sa nē Gorë dhe Opojë e tē shifni deponitë që i kanë krijuar firmat ndërtimore. Për këtë, kërkoj që tē na respektoni dhe t'a qitni nē rend dite pikën lidhur me deponitë, tē cilën pikë do t'a shqyrtojmë dhe do tē marrim Vendim. Ne këtu e kemi filluar një proces që është inicuar nga drejtori i DEmergjencës e nuk është ndërmarr asgjë, konkretisht? Unë këtu nuk dua tē jem figurë dhe ngis dorën dhe se, para disa ditësh, kemi marr Vendimin pér ndërtimin e shkollës nē Buçe e materiali ka qenë jo serioz e tanë po na del se, ai zotëri, e paska shitur parcelën e paraparaë pér shkollë? Për këtë, unë dhe kolegu i im Nexhat I. dhamë propozime, që duhet t'i paraqitni, pér votim, e tē vazhdojmë me punën, dhe tē na respektoni, se ne jemi përfaqësues tē popullit e ne i përcjellim kërkesat e tyre.

z.Granit Rifaj- z.Zinaida E. përmendi problematikën tejet tē rëndësishme e cila nuk është prezente vetëm nē Gorë, por problemi qëndron nē atë se nuk kemi identifikuar deri tanë deponitë ilegale dhe se ne, si Kuvend, duhet tē përcaktohem pér një lokacion tē tillë, ku firmat ndërtimore do tē hedhnin mbetjet e pastaj tē reagohet? Ndërkaq, sa i përket propozimit tē dytë tē z.Nexhat I. nevoiten më shumë përgatitje dhe tē kemi material, pasi se nuk jemi nē dijeni sa duhet me problematikën?

z.Nexhat Isufi- Do t'a lexoj dispozitën e Ligjit pér themelimin e komisioneve tē këtilla tē aksionerëve, ku theksohet se Komisioni i përgjigjet Kuvendit Komunal lidhur me kompetencat dhe mënyrën e veprimit. Pra, Komisioni i tillë do t'i raporton Kuvendit Komunal, pér çdo vit, siç parashihet me nenin 6.a. Do tē thotë se, kjo pikë, nuk duhet tē jetë nē rend dite sot nē Kuvend, por nevoitet tē themelohet Komisioni, pavarësisht nga ajo sot apo nē seancë tjetër?

Kryetari- Sa i përket propozimit tē z.Zinaida E. ka pasur propozim që tē mbahet edhe seancë e jashtëzakonëshme dhe askush se konteston se kjo çështje e theksuar nga ajo nuk është e rëndësishëm madhe, pasi se paraqet problem real nē Komunën tonë. Propozimi dytë i z.Nexhat I. mendoj se duhet lënë pér seancë tjetër, pér t'u parë se cilat janë mundësítë tona, me kompanitë që bashkëpunojmë dhe që veprojnë te ne. Pra, propozimi është nē rregull dhe i drejtë, por, shumica e delegatëve, nuk kanë informata dhe shënimë lidhur me rëndësinë dhe funksionimin e atij Komisioni. Gjendja mund tē tejkalohet me arsyetimin se këto pika mund tē janë nē rend dite tē seancave tjera.

z.Zaim Hajredini- Për propozimin e dhënë duhet tē deklarohet z.Zinaida E. se a është pér ate që tē jetë nē rend dite sot, dhe tē votohet, apo tē jetë si propozim pér ndonjë nga seancat e radhës, si pikë e posaçme, apo seancë e jashtëzakonëshme? Pra, duhet tē dijmë se propozuesit a po dëshirojnë që këto çështje tē janë sot nē rend dite apo nē seanca tjera?

z.Zinaida Elmazi- Zotëritë nga organizata NBA kanë shprehur dëshirën pér pjesëmarrje nē një seancë tē Kuivendit tonë, ku do tē përfshihet kjo problematikë e cila nuk është vetëm nē Komunën e Dragashit, por nē mbarë territorin e Kosovës. Unë nuk do tē isha pér ate që këtë çështje t'a shqyrtojmë sot, por tē mbahet një seancë e jashtëzakonëshme, ku do tē ftoheshin përfaqësuesit e kësaj organizate, pasi se kjo është nē interesin tonë e që fshatrat tona do tē ishin tē pastëra e nuk do tē ballafaqoheshim me deponitë ilegale, nē çdo hap?

Kryesuesi. Këto pikat mungojnë se është e konsiderueshme përendit e tij, përmes së cilave po  
Kuvend, që kalojmë, në votim, të rendit të ditës e seancës së sotme?

z. Suada Bajrami. Edhe unë doshatë informoj se, në një takim me përfaqësues të OSCE-së e ku  
ishin kryesuesi i Kuvendit, anëtar të Kuvendit e të partive politike dhe ZZBGjinore, kemi themeluari Grupin  
Joformal të Punës të Grave, pasi se ato efizitohen edhe në komunat tjera të Kosovës. Në kete Grup, mua  
më kanë propozuar dhe zgjedh si kryetare, kurse z.Zinaida E. si nënkyetare, që besoj se do të hasim në  
përkrahje te ne.

Kryesuesi. Gjithësesi se do të perkrahim punen tuaj, në të ardhmen, dhe ju déshirojmë punë të  
sukseshme. Kalojmë në pikat, më radhe, të seances.

#### Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Pikë të parë, si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e  
II-të/2019, nëse ka vërejtje apo plotësim...? Nëse nuk ka, e miratojmë, pa vërejtje, Procesvebrbalin e  
seancës së kaluar-III/2019.

#### Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportit e realizimit të  
buxhetit, për periudhën Janar-Mars/2019 dhe fjalën e ka kryetari i Komunës z. Shaban Shabani-

Dëzuar në nenin 36 pikë 1 e ligji 03-L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.20/2008 te datës 04.06.2008) dhe nenin 45.4 të ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/2008 te datës 03.06.2008) paraqes një përmbledhje të shkurtër të Raportit tre mujor financiar për realizimin e buxhetit, janar-mars 2019. Raportet financiare tregojnë informacione lidhur me buxhetin, rrjedhën e parasë së gatshme, të hyrat, pagat, shpenzimet përmallra dhe shërbime, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet, dhe shpenzimet për investime kapitale.

Ky Raport finanziar prezanton të hyrat dhe shpenzimet e muajve janar-mars 2019 - dhe bëjnë  
krahasimin me muajt e ndjerë të 2-viteve paraprake. Të nderuar asambleist, buxheti për vitin 2019  
është miratuar në Kuvend në shumën prej 8,404,652.00 euro, pas bartjes së të Hyrave Vetanakë  
të pasqenuara të vitit 2018 në shumën prej 741,232.83 euro dhe të hyrave nga Fondi i  
Donatoreve të vitit paraprak në shumën prej 13,028.65 euro, buxheti komunal në periudhën  
raportuese arrinë shumën 9,158,913.48 euro. Buxheti komunal ne kete periudhë raportuese eshte  
shpenzuar në shumen 1,262,860.44 euro dhe ne krahasim me periudhen e ndjerë raportuese te  
viti paraprak eshte shpenzuar me shume per 0.76 %. Pagat dhe shtesat- pagat janë më të larta  
ne krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak janë më të larta per 3.10 %, përsye te  
rritjes së përvojës së punës dhe shtesave ne paga. Shpenzimet përmallra dhe shërbime- janë  
me të ulta për 40.67 % në krahasim me periudhën e ndjerë te vitit paraprak. Shpenzimet komunale - janë më të ulta për 19.88 % në krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak.  
Subvencionet dhe transferet-gjate periudhes janar-mars nuk janë bërë pagesa nga kategoria e  
subvencioneve. Shpenzimet për investime kapitale-në krahasim me periudhën e ndjerë te vitit  
paraprak, janë më të larta për 37.89 %. Të hyrat vetanakë të komunës- janë më të ulta për  
18.98 %, në krahasim me periudhën e ndjerë te vitit te kaluar. Në tabelë shihet se certifikatat e  
lindjes, vdekjes, kurorëzimit nuk janë të nivelit të pritshëm por programi këto i regjistrion si takse  
- certifikata tjera”.

z.Naser Myrtezani- Kjo pikë, por edhe të tjerat janë pika të këqija dhe jo profesionale dhe janë shenjë të vetëknaqësisë së pushtetit lokal me punën që bënë?! Raporti i realizimit të buxhetit, për periudhën Janar-Mars/2019, paraqet një kopje të atij të vitit të kaluar. Aty ka folklorizëm të tepruar, se kinëse po përkrahët kultura, sporti, arsimi dhe sektorët tjerë dhe habit ajo se si është përshkruar në Raport, kurse gjendja në terren është krejtësisht ndryshe. Pra, ky Raport është tejet i mangët, duke pasur parasysh pasqyrimin e shpenzimeve në 3-mujorin e parë. Këto shpenzime, të paraqitura në Raport, do të mund të bënte një familje mesatare e jo Komuna?! Dhe, a është e mundur, logjikisht, që Komuna të ketë një Raport të këtill 3-mujor, me të gjitha obligimet e punët e tërësishme në terren që ka? Për këta 3 muaj nuk ka asnjë investim konkret kapital dhe gjendja në terren është krejtësisht e kundërt, se siç paraqitet në Raport? Këtu janë paraqitur drekat e darkat, mishi i qengjit, pizat etj. përmes së cilave është shpenzuar buxheti i Komunës. Mungesa e investimeve në Komunën tonë na ka sjell te gjendja e rëndë ekonomike e që rinia e jonë, për çdo ditë, po largohet, duke emigruar nga Komuna jonë. Kemi raporte se, vetëm gjatë vitit 2019, nga Komuna jonë janë larguar 350 të rinjë dhe se qytetarët janë të zhgënjer me mungesën e investimeve dhe, rasti konkret, është në infrastrukturë, ku rrugët pothuaj se janë të pakalueshme. Rruga kryesore Zaplluxhe-Blaç-Bresanë është shumë e dëmtuar dhe është në gjendje katastrofale e mos të flasim përrugët kryesore për në Dragash deri në Prizren e aty, çdo ditë, kalojnë edhe kryetari, nënkyetari dhe qytetarët tjerë, siç shtë në gjendje katastrofale edhe rruga te "Laku u Rapçës". Pastaj te rruga Zaplluxhe-Lez-Prizren janë dy gropë të mëdha e përkëtë fajtor kryesor nuk është vetëm kryetari, por edhe nënkyetari i cili është pjesë e kolacionit qeverisës, kurse, në nivel qendror, ministri i Minfrastrukturës është nga radhe partisë së nënkyetarit të Komunës e që përkëtë po theksoj se, përgjendjen në infrastrukturë, s'bashku janë fajtor-kryetari e nënkyetari i Komunës. Përkëtë duhet gjetur investues, që këto drejtime rrugore të rregullohen dhe të vehen në funksion.

z.Zaim Hajredini- Sa i përket Raportit Financiar, mendoj se ai ka formën e duhur, edhe pse është fakt se unë do të kisha, shumë më shumë, kritika lidhur me investimet kapitale, se ato duhet të fillojnë sa më herët. Por, ne jemi të vetëdijshëm se si shkojnë procedurat tenderuese te ne, si dhe ndikimi i kushteve klimatike te ne. Ne si parti politike (AKR) e përkrahim këtë Raport dhe nuk e shofim se ka ndonjë shkelje të regullave ligjore, pos asaj nevoje lidhur me shpejtimin e procedurave tenderuese. Siç po shifet, numri e tenderëve është i vogël dhe kjo të jetë edhe kërkosë që, sa më parë të fillohet me procedurat tenderuese, reth investimeve kapitale. Tani jemi në muajin Maj e që mos të ngjanë që, në muajin shtator, të kemi 40% të realizimit të investimeve kapitale?

z.Samidin Xheladini- Sa i përket Raportit që po e shqyrtojmë, ai pasqyron shkallën e ultë të realizimit të investimeve kapitale, si dhe atë të grumbullimit të tatimit në pronë. Përkëtë, nuk duhet bazura shumë në periudhat e kaluara, pasi se ka pasur mjaft gabibime e tani ka lauar % e vitit dhe, nlëse nuk realizohet inkasimi i mjeteve vetanake, ne do të kemi shumën mjeteve të pagrimbulluar dhe investime të parelizuara me kohë e që do të ballafaqohemi me suficit buxhetor? Nga mjetet vetanake, në vitet e mëparshme, tani kemi 18% më të ulët shkallën e inkasimit, nëse nuk llologaritet shuma e pa inkasuara e viteve të mëhershme prej 2 milionë eurove e që kjo brengos, sepse, faktikisht, kemi afro 20% të mjeteve të pa inkasuara. Shpenzimet e deritashme, përmallëra e shërbime, janë 58 mijë euro, për investime kapitale 65 mijë euro, kurse subvencionet e transferet nuk janë hargjuar fare e përbuxhet kemi të parapara diku 8 milionë euro, si dhe mjetet e bartura nga vitet paraprake e qënë tërësi, kemi shumën

buxhetore prej 9.158.913oo euro. Nëse nga kjo shumë e përgjithshme heqen gjysma e mjeteve, që do të shkojnë në paga dhe shtesa, mbetet më se gjysëma e mjeteve për realizim, që do të thotë se, kryetari i Komunës, duhet të ketë strategji për t'u filluar, sa më parë, me realizimin e buxhetit, që mjetet mos të shkojnë në suficit, si viteve të kaluara? Po ashtu, kamë vërjetur se nuk kemi shkallë të mirë të inkasimit të mjeteve vetanake, sidomos nga tatimi në pronë, nga toka bujqësore e cila parashihet, nga qiraja e që këtu kemi rënje të mjeteve për 8 mijë euro. Në emër të kësaj kategoria janë paguar 2 mijë euro, apo 6 mijë euro më pak, krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, edhe te participate për shëndetësi kemi rënje e që, të gjitha këto çështje, janë obligime permanente të pushtetit lokal, që të veprohet sa më shpejtë e sidmos lidhur me realizimine projeteve të cilët janë për të mirën e të gjithë neve.

z.Laurat Krasniqi- Raporti është i njejt si vitin e klauar. Një kategori më ra në sy e ato janë subvencionet e transferet, që janë shtuar për 100% e që për këtë periudhë ato nuk janë hargjuar fare dhe a është kjo për shkak të mos alokimit të mjeteve, apo nuk paska pasur kërkesa të qytetatarëve, klubeve, OJQ-ve etj.?

z.Zinaida Elmazi- Raporti është real, por që duhet, sa më parë, të fillohet me realizimin e investimeve kapitale, pasi se po hyjmë në fazën e pushimeve vjetore, kur na vjen diaspora e që punët duhet shpejtuar.

z.Valon Shabani- Raporti është hartuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Lidhur me modelin, ne mund t'a dizajnojmë edhe ndryshe, me grafikona etj. dhe, nëse mendoni se nuk është detali, mund të ofrojmë edhe verzion të zgjeruar sipas "Free-balances", por me nja 200-300 faqe?! Pra, kjo që e kemi në shqyrtim, paraqet standard për të gjitha komunat dhe është i plotë dhe i saktë. Lidhur me vonesat në realizimin e buxhetit, ju e dini se buxheti është miratuar me vonesa dhe se, gjatë muajit të kaluar, janë alokuar 1/12 e buxhetit, sikurse edhe në muajin e 2-të dhe Marsi është alokuar në tërësi. Po ashtu, edhe punëtori certifikues ka shkuar në pension e këto kanë qenë arsy. Ndërkaq, vitin e kaluar, kishte vërejtje pse është hargjuar buxheti e sivjet pse nuk është hargjuar, sa duhet. Por, duhet theksuar se, disa shpenzime përmallëra e shërbime, që kanë qenë të larta, sivjet janë zvogëluar. Te investimet kapitale, të cilat më së shumëti edhe na interesojnë, sipas raportimit të drejtorit të DUrbanizmit..., në Bordin e Drejtorëve, në procedurë për realizim janë 30 projekte, si dhe është përgjedhur kompania përhartim të projekteve. Sa i përket inkasimt të mjeteve, siç theksova, një punëtor ka shkuar në pension te Zyra e Tatimit në Pronë, si dhe me vonesë i kemi marr CD-të përfatim nga MFinancave dhe, këtyre ditëve, ka përfunduar faturimi nga ana e punëtorëve tonë. Me muajin tjetër, pritet edhe inkasimi i mjeteve nga lokalet komunale, siç pritet shqyrtimi i kërkesave përfundimtarëve, kurse sa u përket klubeve, presim përgjigjen e MEF-uit dhe pastaj do të publikohet ftesa përkundër konkurrimeve.

z.Samidin Xheladini- Ju sugjeroj se lidhur me inkasimin emjeteve, tash më disa vite, kemi ngecje dhe rënje të nivelit e përkëndës përgjegjës edhe ne e sidomos ju, që jeni tash më 12 vite jeni në pushtet. Më herët, kemi dhënë vërejtje, përmallëra kategoritë siç janë shërbimet kontraktuese, e vitin e kalur kishim shumën prej 101 mijë euro e sivjet prej 60 mijë eurove, te shërbimet teknike 15 mijë euro e në 2017 – 3.400,00 euro, shërbimet e anëtarësimit 7.300,00 euro e vitin e kaluar 3.300,00 euro, mobiljet janë 17 mijë euro, më 2017-147 mijë euro naftë përfundimtarëve e në vitin 2018-86 mijë euro e në

2016-76 mijë euro, që do të thotë se kemi shtim prej 100% e, për këto shuma, nuk na u dha përgjigje , për t'u heqir dilemat? Mjetet e kontigjentit janë 445 mijë euro, për dy vite, e këto janë lëshime që duhet kanalizuar dhe rregulluar. Po ashtu, te përfitimi i subvencioneve, nuk e kemi marr Listën që e kemi kërkuar tash më një kohë të gjatë? Te "Stadiumi i Qytetit" kemi pasur vërejtje lidhur me punimet, për çka kërkoj rregull në realizimin e investimeve kapitale, që të realizohet buxheti aty ku kemi nevojë e jo për gjëra të pa nevojshme?!

z.Selman Osmani- Sa i përket Raportit, ai është i pjeshsëm, por që, parmisht, janë disa gjëra që janë përfshi. Por, unë këtu nuk po i shof investimet e parapara kapitale prej 2.7 milionë eurove, që nuk e figurojnë dhe as që kemi raporte të komisioneve, që kisha kërkuar nga drejtori i DEFinancave që, në ndonjerën nga sencat, të na sillet Raport reth realizimit të projekteve të infastrukturës. Këtu po përmenden shifra milionëshe e ne nuk kemi kurrfar Raporti?! Disa nga partitë politike po e shfrytëzojnë rastin e po fotografohen para projekteve dhe po lëvdërohen, sikur ato i kanë realizuar, vetëm e vetëm për të përfituar poena politikë, e që e kisha lutur kryetarin të na sillen raporte të komisioneve, se deri ku është arritur me projektet e investimeve kapitale, sepse nuk janë realizuar projekte të caktuara, si psh.ura Krushevë-Restelicë e që është marri, kur të vjen diaspora e arrijnë deri në 10 mijë vetuira e ajo urë nuk ka përfunduar? Ne, për këtë, kemi propozuar 5 mijë euro, por diçka po shkon ngadalë? Ka pasur mjaft rrëshqitje të dheut-gurëve në rrugën Glloboçicë-Krushevë e drejtorin e DEmergjencës e SHPublike po duhet t'a thërrasim, nga 10 herë, për të thirur ndonjë pastrues dhe, nëse paskemi Emergjencë, athua nuk e paskemi një askavator për deblokimin e rrugës. Për të ardhmen, pra, kërkoj që të kemi raporte më konkrete dhe të qarta, sidomos lidhur me realizimin e investimeve kapitale, që ne i miratojmë nga Kuvendi.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është "për"-15, "kundër"-0 dhe 6 vota "të përbajtura", që konstatoj se emiratuam këtë Rapor 3-mujor buxhetor/2019.

#### Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe, në kuadër të kësaj pike të III-të kemi shqyrtimin e P/Rregullores për caktimin orarit të punës për subjektet afariste në Komunën e Dragashit, hapim diskutimet...?

z.Laurat Krasniqi- Lidhur me këtë pikë, mendoj se, paraprakisht, duhet të mbahet një Diskutim Publik me grupet e interesuara, biznesmenët etj., pasi se Rregullorja u përket atyre. Ne nuk kemi mbajtur Debat Publik lidhur me këtë e unë nuk jam anëtar i KPFinanca dhe se dijë se çka është vendosur në mbledhjen e tij. Prandaj, mendoj se duhet të miratojmë Vendim për Diskutim Publik, pasi se, pa te, mund të keqëkuptohemi dhe ndikohet negativisht në këtë proces.

Kryesuesi- Ne kemi biseduar në KPFinanca dhe jemi dakorduar që, kjo P/Rregullore që e kemi në shqyrtim, të jepet për Diskutim Publik me qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara e, pastaj, të miratohet, edhe nga Kuvendi.

z.Zinaida Elmazi- Dje, në KPFinanca, me propozimin e kryetarit, kami vendosur që P/Rregullorja që e kemi në Kuvend të dërgohet për Diskutim Publik, edhe pse se dij se cili ka qenë qëndrimi i KKomititete, që dëshiroj të prezantohet edhe qëndrimi i tyre?

z.Munir Jonuzi- Po paraqitem në cilësin e kryesuesit të KKomunitete dhe po theksoj se, edhe ne duke e trajtuar këtë pikë-P/rregullore, kemi marr qëndrim unanim, që ajo të shkon në Diskutim Publik, para së gjithash, me subjektet afariste , si dhe me qytetarët e interesuar e që, pastaj, të miratohet edhe nga Kuvendi.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është "për"-24, "kundër"-0 dhe 0 vota "abstenim", që konstatoj se miratum Vendimin për Diskutim Publik, të sajë.

#### Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Në kuadër të pikës së IV-të (katërtë) të rendit të ditës kemi Kërkesën e delegatit tonë z.Sefidin Mejzini, për terren sportiv në "mejdan", hapim diskutimet...?

z.Sefidin Mejzini- Kjo Kërkesë s'ka asgjë personale me mua dhe ajo bazohet në ligje dhe nene, kurse parcelat janë pronë komunale e këtë e kam vërtetuar zyrtarisht. Ato parcela janë në ZK të Bellobradit, që unë nuk po ëndërroj sy hapur, por si të gjith tjerët dhe ëndërroj që ajo pjesë të ketë terren sportiv. Po ashtu, do të mndërlidhem me kolegen (Z.E.) e cila përmendi deponitë e që është evidente. Unë kam kërkuar që kjo çështje të realizohet me ndarje apo me ndërrim të teritorit e para nesh e kemi Ligjin. Arsyetimi se pse ajo pjesë duhet të ketë terren sportiv janë këto fotografi...dhe pjesa është më e rrafshët-"Mejdan" e kjo pjesë është mbuluar me mbeturina të ngurta e kjo nuk është e natyrshme. Sapo u njoftova se se fshati i përmendur-Bellobrad qenka ankuar dhe jam i vetëdijshëm se ai fshat ka njerëz të mirë dhe të arsimuar, por që duhet studiur si fenomen për Baëëkanin?! Por, në pyetje është ndërtimi istadiumit dhe secili kërkon që ai të transferohet në vendijn e tyre dhe për këtë po theksoj se janë fenomen, pasi se po dëshirojnë të largojnë atë ndërtim. Se a i takon ajo pjesë fshatit bellobrad apo kapre unë nuk po merrem, por po merrem me dokumente dhe se di se cili është pretendimi ndaj kësaj çështjeje dhe çka qëndron prapa kësaj iniciative. Ne jemi një territor i përbashkët si Komunë e Dragashit dhe mjetet duhet t'i shpërndajmë në tërë tetritorin e Komunës. Nuk kam asgjë kundër drejtorit të DKRSportit, por pse aktivitete tona të mbahen në Prizren, pasi se kemi shkolla të futbollit të cilat parashtronin kërkesa për të shkuar, ushtruar e zhvilluar gara atje, duke kërkuar përkrahje për transport e kemi informata se janë ndarë 280 mijë euro për "Stadiumin e Dragashit" e ai stadium mund të quhet i masakruar?! Kemi 2 shkolla të futbollit e që shkojnë për ushtrime e gara në Prizren apo Suharekë, që është absurde. Ajo që kérkoj është plotësimi i një ëndërre dhe atë stadium unë nuk do t'a marr në shtëpi, por që ai lokacion është epiqendër e Komuns sonë e që meriton të ketë stadium. Unë jam i vetëdijshëm, pas bisedës me kryetarin e Komunës, se ajo pjesë e territorit është njëfar kontesti gjyqësor. Por, duke pasur parasysh se njerëzit i shfrytëzojnë ato parcela, tash e sa vite, pse mos të tentojnë të marrin atë pjesë për destinacion sportiv-stadium në shfrytëzim, kurse shfrytëzimi për 1 ha është 50,00 euro? Në këtë fotografi mund të shifet rruga "Bil Clinton" dhe këtu në këtë pjesë kemi rrjedhën e kanalizimit dhe erë të pa përballueshme nga kundërmimi i tij e pse qytetarët nuik paskan bërë kërkësë për zgjidhjen e këtij kanalizimi? Z.kryetar, nuk kam asgjë personale dhe duhet të dijmë se i kemi shtyrë të moshuarit të na votojnë, nuk kemi mundësi t'u ofrojmë pensione të mira, nuk kemi mundësi të punësojmë punëtorë të rinjë dhe të hapim fabrika dhe të mundësojmë sigurimin e një vendi se ku do të dalin me nipërit e tyre për t'u dëfryr. Ai stadium i ish-"Graniçarit" në Dragash nuk i plotëson kushtet infarstrukturale dhe, kur na vijnë mysafirët,

duhet t'i transportojmë në vende tjera, apo të shfrytëzohen vetura, më të vogëla deri te ai stadium?! Prandaj, s'di se pse pretendoni që të orjentonit në atë Stadium edhe 230 mijë euro?! Neni 13 i Ligjit flet për mënyrën e këmbimit të pronës komunale dhe, nëse Komuna ka interes për pracelë të caktuar, ajo Kërkesë duhet të parashtronet, me dokumentacion përkatës, siç janë: Vendimi për shpalljen e interesit publik, që do t'ë thotë se ne duhet duhet të shpallim atë interes për atë parcelë, pavarësisht se a është në kontest?!

z.Zinaida Elmazi- Ne, dje, në KPFinanca e kemi shqyrtuar këtë Kërkesë dhe askush nuk ka qenë kundër Kërkesës, por problemi më i madh qëndron se Komuna është në kontest me AKP-në dhe, për këtë, kërkesat e këtilla nuk mund t'ë realizohen, përderi sa t'ë kemi kontestin me AKP-në. Ne, si duket, po merremi me kërkesa jo serioze, pasi se edhe në seancën e kaluar kemi pranuar Kërkesën për ndërrim të palujtshmerisë komunale lidhur me ndërtimin e shkollës në fshatin Buçe. Për këtë, unë isha e "përbajtur", pasi se ajo Kërkesë nuk ishte adekuate e adresuar? Nuk kishte pëlqimin e pronarit të parcelës dhe erdhëm në situatë në të cilën jemi edhe sot, pasi se zotériu i cili ka qenë i gatshëm t'a ofron parcelën për ndërrim, në ndërkohë, parcelën e paska shitur - privatisht?! Prandaj, unë do t'ë kisha kërkuar nga kryetari që, lidhur me kërkesën tuaj, t'ë na jep më shumë informata, për t'ë miratur sot Vendim adekuat dhe, mos mendoni se unë jam "kundër" Kërkesës suaj, por që t'ë na njoftojnë organet kompetente lidhur me kontestin e Komunës me AKP-në dhe gjendjen reth asaj parcele?

z.Sefidin Mejzini- Sa i përketë jo seriozitetit të Kërkesës, unë kam qenë tejet i vetëdijshëm për këtë dhe me këtë nuk ka dëshiruar askend t'ë ofendoj, që këtë t'a bëj për qëllime politike, por këtë e kam bërë "për t'u lëvizur disa gjëra"? Ne nuk mund t'ë jemi viktimë e një kontesti gjyqësor i cili zgjat 20 vjet. Për këtë, ekzistonjë edhe mënyra tjera dhe prona komunale jepet në shfrytëzim, për një hektar 50,00 euro e kjo t'ë merret parasysh, e jo t'ë pritet nga unë për kërkesë t'ë këtillë dhe, për komunën, do t'ë ishte më mirë, që një herë t'ë inicon këtë çështje dhe procedurat e jo që, për çdo javë, t'ë ballafaqohet me kërkesat e shkollave e klubeve të futbollit?! Ajo pjesë është më e mira dhe më e rafshta në komunën tonë dhe askush nga ne, privatisht, nuk i vendos mbeturiant aty ku është më rafshët e atje kryetari kalon, çdo ditë, dhe është koha që, ai vend, t'ë ndien "erën e shtetit" dhe s'di pse fshatit Bellobrad do t'i pengonte ai stadium e që t'ë ankohet?!

z.Zinaida Elmazi- Mua më duket e pakëndëshme, por askush nuk është kundër Kërkesës së këtill, por problemi qëndron në atë se Komuna ka masën e përkohëshme - t'ë ndalesës, pasi se është në kontest me AKP-në dhe për këtë kërkova, nga kryetari, që t'ë jepen sqarime më t'ë sakta. E dyta, unë nuk theksova se kjo Kërkesë është jo serioze dhe "mos e gjuani topin" në mua, pasi se nuk theksova se nuk do t'a përkrahi Kërkesën, përkundrazi, do t'a përkrahi, por atëherë kur t'i dëgjojmë t'ë gjitha informatat e nevojshme, pasi se nuk dëshiroj t'ë përkrahi diçka që është e jasht ligjshme. Unë, edhe herën e kaluar, isha "e përbajtur" e ju, tjerët, ngritët dorën për atë Kërkesë jo serioze e çka përfituar-pronari e shiti atë parcelë t'ë paraparë për shkollë, sikurse që më vjen keqë që ajo hapësirë që theksohet tanë qenka shëndërruar në deponi?! Prandaj, ju lutem që herëve tjera, kur t'ë replikoni, mos më keqëkuptoni ose shfrytëzoni dëgjueset e përkthimit dhe dëgjoni se çka flas, apo, ndoshta, nuk po u përgjigjet dhe nuk po dëshironi t'ë dëgjoni? Më vjen shumë keqë se, kur janë në pyetje diskutimet e komunitetit jo shumicë në

një kolegu? Këtu, tani kemi rastin se lëndë shqyrtimi e kemi pronën e dy pronarëve e aty e kemi deponinë e për këtë, bashkarisht, duhet të vepron Komuna me AKP-në. Të gjitha çështjet në Komunën tonë janë të ndërlidhura, nuk kemi Plan Urbanistik, nuk kemi rrugën deri në Stadium të Dragashit, po na kërkohet shpallja e interesit publik të rugës deri atje. Për këtë çështje, duhet pasur mirëkuptim, pasi se kryetari dhe kryesuesi i mëparshëm kanë bërë nëpër gjykata gjatë mandatit të tyre për shkak të kontestit me pronën e "Sharrprodhimit" e mos t'u krijojmë probleme edhe kryetarit dhe kryesuesit të tanishëm?! Nëse ka mundësi, edhe një grup i delegatëve tonë, të bisedon me AKP-në reth pronave, që të tregohet mirëkuptim për këtë rast të stadiumit dhe të ndahen 2/ha troll, pasi se ne, që nga viti 2008, kemi miratuar Vendimin për rikthim të pronës Komunës e që ai nuk po zbatohet sot e kësaj dite dhe kemi pronën me 2 pronarë?! Kisha kërkuar nga kolegët të mos më keqkuptojnë, sepse unë nuk do të votoj për një Vendim të tillë në këtë formë, siç mendohet?!

z.Samidin Xheladini- Ne përkrahim këtë iniciativë, pasi se mendojmë se është në interes të qytetarëve e sidomos të rinjëve. Ndërkao, sa i pëket anës juridike, duhet të përkujdesen shërbimet kompetente komunale, pasi se nuk është në pyetje stadiumi me material të fortë, por vetëm një terren ku do të zhvilloheshin aktivitete sportive dhe, nëse lejohet, do të paguhet shuma e paraaprë për shfrytëzim dhe kërkoi që Komuna t'i adreson një Kërkesë AKP-së për shfrytëzim të pronës, pasi se këtë e lejojnë dispozitat e neneve të Ligjit 04/L 144... ku, në mes tjerash, theksohet se komuna ka të drejtën për rikthim të pronës, kur është pyetje interesit publik, që apeloj në kryetarin të mendon për atë që, e tërë prona shoqërore, t'i rikthehet Komunës?

Kryetari- Sipas diskutimeve paraprake, fitohet përshtypja se Kërkesa është e arsyeshme, por shumica pajtohet se ajo nuk i plotëson procedurat ligjore, si dhe duhet pasur parasysh masën e përkohshme gjyqësore e cila nuk lejon dhënien e pronës shoqërore, Siç e dini, ne kemi Vendimin e mëhershëm për për rikthim të ronës komunale nga ana e AKP-së e, për të vendosur për këtë, ne duhet të térheqim Vendimin e mëparshëm të Kuvendit e pastaj t'i parashtrojmë Kërkesë AKP-së, për të na lejuar shfrytëzimin e parcelës së tillë. Ju, poashtu, e dini se Qeveria ka miratuar Vendimin për rikthim të pronës dhe jemi afër realizimit të këtij qëllimi dhe, kur të jemi në atë moment, do t'a kemi më lehtë. Për momentin, duhet pasur parasysh pengesat që i i krijon Aktvendimi i Gjykatës e që nuk kemi të drejtën e veprimit. Unë nuk do të flas për rëndësinë e kësaj Kërkeze, pasi se këtë e theksuan delegatët e, për veprim, të presim momentin e vendosjes, kurse këtu duhet pasdurr parasysh edhe reagimin e e komunitertit që jeton në atë pjesë, pa u lëshuar në atë se a kanë apo jo të drejtë? Sa i përket Stadiumit ekzistues, MKRSportit ka paraaprë edhe 100 mijë euro, edhe pse e dijmë, se për momentin, atje kushtet janë kurrfare dhe ne nuk jemi të kënaqur me cilësin e punimeve?!

z.Zaim Hajredini- Unë pajtohem me kolegët dhe pajtohem me dëshirën e mirë të kolegut Sefidin Mejzini, që të kemi në terren sportiv e që kështu t'i kontribuojmë për të mirë komunitetit. Nëse ju kujtohet, unë brengë të ngjashme kam shpehur edhe me rastin e miratimit të buxhetit, e ku u fol për stadiumin në Dragash, pasi se disa nga klubet ne i ndihëmojmë që të mbijetojnë përmes zhvillimit të aktiviteteve në Prizren te stadiumi i "Lirisë", por që janë të diskriminuar në sfrytëzimin e tij në kohë të pa përshtatshme, sepse u jepet përparësi klubeve të komunës së Prizrenit. Lidhur me këtë Kërkesë, dy kemi aspekte e njeri u përmend lidhur me apskrinin juridik, kurse tjeri është se duhet të merren parasysh dhe

foltore, ju nuk po e shfrytëzoni përkthimin e po theksoni se "nuk po kuptojmë"?! Unë, nuk po kuptoj, dhe për këtë kërkoj përkthim.

z.Artan Loshaj- Lidhur me kérkesën e kolegut tonë Sefidin Mejzini, unë e përkrahi, por më duhet të them se pak sa jamë skeptik, edhe pse unë, sipas natyrës, jam sportist dhe, për këtë, kérkuam sinqerime shtesë, nga kryetari. Sa i përket stadiumin të qytetit në Dragash, mund të them se, edhe para fillimit të investimeve, aty kanë luajtur futboll fëmijët tanë, si dhe janë mbajtur manifestime të ndryshme, përfshi edhe garat e futbollit të KF "Opoja", si i vetmi klub i cili na përfaqëson-si Komunë. Por, mjerisht, edhe përkundër investimeve kapitale të mbi 200 mijë eurove, ai stadium është shëndërruar në deponi dhe unë ju kisha latur si kolegë që, personat përgjegjës për këtë gjendje, t'i dërgojmë në gjykatë për procedura të ndëshkimit të tyre? Dihet se, për këtë stadium, dikush ka marr mjete dhe se dikush i ka pranuar punimet dhe, ai Komision, duhet të dënohet sipas ligjeve. Tani, fëmijë tanë aty nuk po luajnë futboll, por po i dërgojmë në Prizren dhe KF "Opoja", për gara në stadium, po paguan mjete e ne në KPFinanca po i përkrahim me mjete, për të siguruar, s'paku për ata lojtarë, nga një shishe ujë?! Sa i përket rrugës deri te stadiumi, atje 2 vatura luksoze nuk mund të kalojnë dhe mysaferët për stadium po detyrohem i transportojmë me taksi?! Për këtë, kam kérkesë për kryetarin që, seriozisht, të merret me këtë çështje, pasi se, kryetari paraprak, nuk na ka përfillur?! Po ashtu, nga delegatët e komunitetit jo shumicë kérkoj të kontribuojnë, pasi se parcelat ku kalon rruga për në stadium janë të komunitetit jo shumicë, dhe se ajo rrugë duhet të shpallet rrugë e interesit publik e për këtë janë dhënë premti edhe gjatë fushatës zgjedhore?!

z.Laurat Krasniqi- Parimisht, Kérkesa është e mirë, por në princip, mendoj se po bëjmë gabim, pse? Siç e dijmë, Kuvendi ka miratuar Vendim që pronat komunale, në pronësi të përkohshme AKP-së, t'i rikthehet Komunës. Pas kësaj, kemi Vendimin Definitiv të Qeverisë e cila është e vetmja kompetente për pronësinë e AKP-së. Tani, nëse ne veprojmë kështu, siç shpresojmë, do të na del se po veprojmë kundër vetëvehtes dhe po thejmë ligjet dhe nuk mund, ne si Komunë, të miratojmë vendime për pronën nën pronësi të tjetër kujt?! Gjykata ka vendosur dhe nuk mund t'i shkelim vendimet e tij, nga arsyaja e thjesht se, në të kaluarën, është bërë gabim e ne tani jemi viktima të sajë?! Te stadiumi, po flitet se do të investon MKRSportit dhe, pavarësisht se çka folën më herët kolegët, çështjen e investimeve në stadium duhet quar deri tek përmbaruesi, pasi se atje janë bërë punë për 20-30 mijë euro e janë paguar mbi 200 mijë euro?! Kjo paraqet keqpërdorim të taksave të qytetarëve dhe unë jam i gatshëm për këtë proces, para vedit e kam dokumentacionin tenderues dhe prapa stadiumit janë dashur të ndërtohen tribunat dhe askush nuk i është përbajtur paramasave e paralogarive të tenderimit dhe, kushdo qoft që është në pyetje, duhet të përgjigjet?! Kryetari këtë obligim është dashur patjetër t'ia delegoj dikujt?! Lidhur me Kérkesën, mendoj se nuk është dashur të jetë në rend dite, por meqenëse e kemi në rend dite, po e diskutojmë. Por, realisht, është bërë gabimi, pasi se kemi Aktvendimin gjyqësor.

z.Velid Haxhisin- Kérkesa që e kemi në shqyrtim, për shkaqe procedurale, nuk është dashur të jetë në Kuvend, pasi se nuk i plotëson kriteret në formë të shkruar, përfshi edhe nënshkrimet e 1/3 të delegatëve, pasi se nuk bazohet në Ligj dhe Statut. Pra, ne e kemi këtu Kérkesën e arsyeshme, por për të futur diçka në rend dite, unë 3-4 ditë kam bëdhur, për të mbledhur nënshkrimet e delegatëve të nevojshëm për seancë të jashtëtakonëshme lidhur me hidro-centralet e tani e kemi Kérkesën, vetëm të

dëshira e mirë dhe fakti i ekzistimit të deponive të ngurta ilegale atje. Këtu duhet të identifikohemi me ate se si ndihen ata që merren me sport, duke marr parasysh faktin se ai terren është epigendër e shumicës së fshatrave në atë pjesë, kurse si opzion për shfrytëzim të terreneve sportive është edhe stadiumi në Blaç i cili i plotëson disa kritere më shumë se sa stadiumet tjerë e që ka mundësi, s'paku, atje të zhvillohen treningjet?

z.Sefidin Mejzini- Po përsërisë se kjo Kërkesë nuk ka ngjyrime politike. Unë jam i vetëdijshëm edhe për Aktvendimin gjyqësor që e kemi dhe ajo që më së shumti më nxiti është diskutimi i z.Velid H. i cili theksoi se ne duhet të tërhiqemi dhe të trokasim në zyrat e AKP-së, kurse sa i përket diskutimeve të koleges Zinaida E. mendoj se ate duhet rikthyer në klasën e I-rë dhe, më vjen keqë, që këtu jam bashkë me te e ne këtu jemi për të përfaqësuar popullin, që na ka dhënë votën, dhe unë nuk i shfrytëzoj dëgjueset, pasi se ajo nuk e meriton që të dëgjohet! Sa i përket asaj se Kërkesa qenka jo serioze, ajo nuk mund të jetë serioze, për ju të cilët nuk e shifni të arsyeshme për të vepruar, pasi se janë investuar mbi 200 mijë euro e tani po dëshironi të investohen edhe 230 mijë euro të tjera në një stadium të Dragashit, ku as bagëtia nuk do të kullotet e jo që të luajnë fëmijët tanë?! Pasi se Kërkesa e ime është e tillë, mund të pezullohet për kohë të caktuar, kur të krijohen kushtet për ndërtimin e atij stadiumi. Nuk po dëshiroj të them se kam bërë gabim me rastin e paraqitjes së kësaj Kërkesë, por vërtetë dëshiroj që në atë vend të kemi një ditë stadiumin e jo të jetë deponia ilegale e mbeturinave të ngurta. Nëse keni frigë nga burgu, po them se askush nga Komuna nuk ka shkuar në burg, por, sidoqoft, pasi se situata është e këtillë, kjo Kërkesa ime të tërhiqet dhe të pret për një kohë të caktuar e më të volitshme kohore.

z.Nexhat Isufi- Të jemi të qartë se Kërkesa është e mirë dhe e qëlluar dhe se të gjithë jemi për ndërtim të stadiumit të tillë. Por, nevoitet që, në një kohë të arsyeshme, prap, të inicojmë këtë çështje dhe tani kërkoj që mos të votojmë "për" apo "kundër" kësaj Kërkesë, por për shtyerje të sajë në kohë të caktuar dhe të përshtatshme?

z.Granit Rifaj- Se sa është i nevojshëm një stadium i këtill dhe Kërkesa e kolegut është çështje padiskueshme, por duhet pasur parasysh se, nëse miratojm një Vendim të tillë, do të kemi menjëherë një padi ndaj kyretarit dhe kryesuesit të Kuvendit. Meqenëse kjo Kërkesë do të shtyhet, për kohë më të përshtatshme, unë do të proozojë një debat publik me qytetarët e Bellobradit dhe të dëgjojmë kërkessat e arsyetimet e tyre dhe t'u sqarohet se është më mirë të kemi atje stadium se deponi ndërtimore, për të pasur gjuhë të përbashkët?

z.Laurat Krasniqi- Sa i përket rendit të ditës, mund të them se është bërë lëshim, pasi se edhe unë propozova plotësim të rendit të ditës, i cili nuk u muar parasysh? Në këtë situatë, që jemi tani, po duhet të shtyjmë Kërkesën, në vend që të votojmë "për" apo "kundër", pasi se kjo çështje do të shkon në MAPL, për shqyrtim të ligjshmërisë?

z.Zinalda Elmazi- Meqenëse të gjithë janë për terren sportiv, prap, po vijnë në situatë si të jemi fillestar e këtu jemi përfaqësues të popullit, që duhet të respektojmë ligjet. Ne dijmë fortë mirë se Komuna është në kontest pronësor dhe se kjo nuk duhet të votohet dhe, pasi të përfundon ai kontest me AKP-në, prap, mund të bëhet Kërkesë dhe, gjithësesi, në do të votojmë, për terren sportiv. Pra, nuk ka nevojë që t'i shkaktohen probleme kryetarit, pasi se probleme të tilla ka pasur mjaft, kryetari paraparak.

z. Refik Latifi- Sa i përket Kërkesë së kolegut theksuam se ajo është e mirë dhe e qëlluar. Por, për shkak të situatës së krijuar dhe ekzistimit të kontestit me AKP-në, mendoj që Kërkesa të suspendohet apo përkohësisht të pezullohet dhe, në momentin kur të krijohen kushtet e reja, Kërkesën t'a rikthejmë për shqyrtim dhe se nuk ka nevojë të votojmë, "për" apo "kundër"?

z. Samidin Xheladini- Shpesh na ngjanë që të marrim sqarime nga personat përgjegjës apo delegatët që janë të barabartë me ne, nga pozita apo opozita. Kështu, si duket. Komuna e paska caktuar zëdhënësin, por që këtu shumë kush po paraqiten si të tillë, duke folur në emër të Komunës?! Pra, z.kryetar a e keni zgjedh zëdhënësin dhe se duhet të dijmë se kush pyet e kush jep përgjigje dhe nuk ka kurfar nevojë, që delegatët të na jasin përgjigje, nga se dihet se kush duhet t' i jep ato?! Këtu, nuk ka nevojë të dilet dhe të promovohet liberalizmi dhe të jetë kjo, koha e fundit, që të na jasin sqarime në emër të tjerëve. Mendoj se për këtë Kërkesë termi i vërtetë është prologim i sajë, pasi se me këtë u pajtue edhe parashtruesi i sajë, e që edhe mendoj se duhet të pajtohami.

Kryesuesi- Pra, pasi se pajtuam me këtë qëndrim, kalojmë në pikën e radhës – "eventuale"...

**Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës "eventuale"...**

z. Artan Loshaj- Pasi se unë kam parashtruar pyetje, lidhur me rrugën kah stadiumi në Dragash, nuk kam marr përgjigjer dhe nuk dijë se sa kryetari a ka diponim për këtë rrugë? Nuk jam kundër askujt, por po i drejtohem delegatit të AKR-së (z.Z.H.), që mos të orjentohet çështjet që po i diskutojmë në kahje tjetër-kah Blaçi apo Kosava, por kah korruzioni, nga se ne jemi këtu bashkarisht e që ashtu duhet t'a kritikojmë gjendjen reth stadiumit të "Graniçarit", pasi se atje është bërë katastrofë me invesitim e mbi 200 mijë eurove e ja se për këtë kemi edhe fotografitë e kolegut... e unë kam edhe videot e atij stadiumi dhe pothuaj, çdo ditë, jam atje ku gjendja është katastrofë dhe për marri, pasi e ai vend mund të ngjan në gjithçka, por jo në stadium?! Edhe një pyetje, e ju e dini, se ne kemi mbetur pa gjinekolog dhe çështja është përmendur edhe në Parlamentin e Kosovës, kurse më 08.05.2019 në Komunën tonë do të qëndrojnë grupi i 6 deputetëve të Parlamentit të Kosovës, për takim publik me qytetarë. Tani kam informata se, disa nga mjekët e rinjë, kan probleme me licencimin, pasi se jasht vendit kanë kryer shkollime e po dëshirojnë të kontribuojnë në vendlindje, që shfrytëzoj rastin të apeloj tek kryetari që të shfrytëzon autoritetin e tij për të biseduar me Ministrin e MSHMSociale, i cili është nga radhët e PDK-së, pasi se ashtu, siç po kërkojmë tani, nga Prizreni apo Prishtina, e do të jemi në gjendje që të kërkojmë edhe mjekë të praktikës së përgjithshme. Këta mjekë të rinjë po dëshirojnë të jasin kontribut këtu, por disave, për çështje politike të votimeve, po u pengon që ata të kanë licenca. Një rast të tillë, të një mjeku të ri nga Krsueva e kemi pasur në, pasi se i është thënë "nuk ke licencë" e që ai tani po punon, si mjek, në Turqi?! Kështu, po na del se më lehtë është të punësohen mjekët tanë në Gjermani, Francë... se sa në Kosovë! Kjo është çështje serioze dhe kjo, me siguri, do të inicohet në takimin e cekur të 08.05.2019 me deputetët e Parlamentit të Kosovës. Ju lutem, ne kemi nevojë për mjekë dhe qytetarët tonë nuk e meritojnë gjendjen e këtill që e kemi dhe, të lehet anash politika e cila nuk duhet të ndërhynë në mjekësi?!

z. Zaim Hajredini- S'di se sa u kuptova lidhur me stadiumin në Dragash dhe se nuk kisha asnjë me atë se kush ka punuar dhe kush është fajtor dhe se, pikrisht ti (z.A.L.) ke qenë ai i cili e ke prezentuar një fotografi të gjendjes në atë stadium dhe unë, si atëherë edhe tani, jam kundër përkrahjes së asaj që është

kryr si punë e keqe, pasi se është lehtë të fitosh tender e mos të krysh punime. E dyta, unë nuk kam qenë nënshkruers i pranimit të punimeve dhe, bashkarisht me ty, e sulmoj punën e keqe jo vetëm te stadiumi, por të të gjitha punëve tjera të kryera dobët. Unë desha të përmendi dëshirën e mirë të delegatit tonë Sefidin Mejzini, që është e nevojshme të shfrytëzohet stadiumi në "Mejdan" dhe, nëse sot akuzohet pynëkryesi në stadiumin e Dragashit, edhe unë jam për atë, edhe pse nuk e dij se kush ka qenë punëkryes, por ato punë dikush i ka pranuar. Firma e cila ka punuar e ka Projektin, e mund të shifet se si qëndron çështja, kurse nëse dëshirojmë të ndërmarrim diçka, përkohësisht, për stadium, mund të bëjm diçka me stadiume në Blaç apo Bresanë, deri sa të krijohen kushte më të mira, nga se klubet nuk kanë se ku të ushtrojnë.

z.Laurat Krasniqi- Dëshiroj të theksoj brengat reth KF "Opoja" dhe, sipas informatave zyrtare që kam, ai Klub është OJQ e tanj, pasi ka kaluar në pronësi të tjetër kujt, është ndryshuar llogoja?! Po theksoj se ai Klub përfaqëson popullin dhe nuk e ka themeluar as Komuna as Kuvendi e kanë pasur obligime institucionale. Komuna ndan fonde e, këtë vit kemi pasur 30 mijë euro për subvencione dhe, realisht, KF "Opoja" ka përfituar më së shumëti, pasi se është klub më i madh e kryesor te ne. Prandaj, mos të qëndrojmë duar kryq, pasi se pronari i mëparshëm ka kontribuar aq sa ka mundur, por mos të vjen Komuna në situatë, që mos të dihet se kujt po i ndahen fonde në emër të KD "Opoja", të parit apo të dytit?! Për këtë problematikë të krijuar, ekzekutivi i Komunës duhet të ofron zgjidhje, pasi e psh KF "Liria" i Prizrenit ka aksione, kurse ky i yni është OJQ dhe, nesër, mund të hap xhiro-llogari dhe mund të grumbullon mjete, pasi se kështu kanë vepruar shumë institucionë, kur kanë filluar veprimtarinë.

z.Rexhep Kamberi- Unë kam disa pyetje për kryetarin? E para, kur do të fillohet me hartimin e Planit Urbanistik, që si pyetje e kam parashtruar, disa herë, pasi se është probelm kyç i Kornunës sonë. Jam i vetëdijshëm se ky ështën Projekt i madh dhe se nevoitet kohë e mjete e për këtë kemi probleme, siç u përtmend rruga kah stadiumi i "Graniqarit", që ka nevojë të hapet rruga, siç ka nevoja hapja e rrugës në "Dragashin e Poshtëm". Për këtë, unë e kisha lutur drejtorin e DUrbanizmit, që në afat sa më të shkurtër, të hartohet një pjesë e Planit Urbanistik, apo pikat kyçë ku kemi probleme, që në ato pjesë të shpallet interesit publik? E dyta, lidhur me Raportin 3-mujor buxhetor, për investimet kapitale, kërkoi të dihet se kush investon nëpër fshatra, se a i investon Komuna apo partitë politike, pasi se si promotore të tyre po paraqiten partitë politike, kur po përfundojnë projektet, duke theksuar se i kanë plotësuar premtimet elektorale?! E treta, si është e mundur që, në vendin e punës në ZLKKthimit, të pranohet punëtori nga Komuna e Prizrenit, kurse dihet se kanë qenë të paraqitur, s'paku, 5-6 kandidatë të komunitetit jo shumnicë te ne, konkretisht, të komunitetit Goranë? Të gjithë kandidatët u refuzuan dhe u paraua personi, me vedbanim në Prizren? Këtë pyetje e kam parashtruar edhe më herët, por nuk kam marr përgjigje. Edhe një pyetje, z.kryetar, se më krijon huti deklarimi i juaj se, shtëpit për rastet sociale, po ndërtohen me iniciativën e e Adem Hoxhës dhe klubit pralentar 6+? Me sa e dij unë, në përshtimin e punëvbe dhe detyrave të delegatëve, ata nuk jepin iniciativa të tillë, por se dokumentet përcillen përmes ZLKKthimit e për këtë nuk keni dhenë përgjigje adekuate e gjithçka po ngjan si "marketing politikë" të këtyre subjekteve politike?!

z.Hajrudin Hoxha- Një pyetje për kryetarin e Komunës e të dëgjojnë edhe delegatët se ajo ka të bëj me atë se, më herët, kemi diskutuar përrugën Glloboçicë-Krushevë e cila është e dëmtuar gjatë tërë

vitit e tani na vjen diaspora e ata nuk e dijnë këtë, të shpresojmë se ajo rrugë do të rregullohet? Po ashtu, pa 2 ditëve, në Restelicë, ka qenë Policia dhe masovikisht ka filluar të dënon qytetarët e Restelicës, për shkak të mosrespektimit të parkimit në qendër të Restelicës e që qytetarët dëshirojnë të dijnë se kush e ka ftuar Policinë, për të dënuar qytetarët e sajë dhe se dijmë se a kemi rastet të tillë të dënimive të qytetarëve në fshatrat tjera të Gorës e Opojës, sidomos të atyre që arrijnë për pushime nga diaspora, Nëse ky është Vendim i Komunës, në rregull, por nëse është kërkesë e ndonjë delegati apo qytetari, kjo nuk është në rregull? Kur qytetarët kanë pyetur Policinë se kush ju ka dërguar-ftuar ata kanë dhën përgjigjen "ju na keni ftuar"? Falë Zotit, në Restelicë të gjithë kanë emra e mbiemra dhe përfaqësues të fshatit e që qytetarët pyesin se kush ka mundur të bënë ftesë të tillë e nuk dihet se ka shenjë të ndalim-parkimit?!

z.Zaim Hajredini- Edhe unë kam një pyetje lidhur me "Gurin e Zi" dhe dëshiroj të dijë se si qëndron konkretisht gjendja, se a do të përfundon ajo rrugë? Dhe, nëse nuk do të kryhet, pse nuk do të kryhet dhe kush e bartë përgjegjësinë, pasi se, që 2 vite, kemi paraparë mjetet në shumë prej 100 mijë eurove e deri ku do të mbërrihet me ato? Theksohet se ai qëndrim qenka ndryshuar me projekt 3-vjeçar e, siç duket, tani nuk ka asgjë nga kjo?!

z.Zinaida Elmazi- Unë desha të ndërlidhem në kolegut Rexhep K. lidhur me punësimin e punëtorit të sjell nga Prizreni në ZLKKthimit, që kisha kërkuar nga kryetari sgrarime, pasi se, në mesin e kandidatëve, ka qenë edhe një femër-kolegja e ime-Silvija, e cila ka përfunduar fakultetin, dhe si qëndron çështja? Parashtroj pyetjen se pse nuk po veprohet barabartë me këto çështje, sidomos kur janë në pytje gratë tona nga komuniteti jo shumicë dhe, nëse bartim funde të shkurtëra, nuk do të thotë se nuk jemi të afta, si dhe theksoj ate se, fundet e shkurtëra, u kontribuojnë mandateve më të gjata?!

z.Velid Haxhisin- Kjo që do të theksoj nuk do të jetë pyetje, por Apel për kryetarin dhe ekzekutivin e Komunës, që të mbrohen tregtarët lokal dhe biznesmenët e Komunës sonë nga konkurenca jo lojale e cila është dukuri gjatë sezonit veror e që paraqiten si "kërpurdhat pas shiut", e që nuk janë të regjistruar, e tregtarët legal mezi po e tejkalojnë dimërin e në sezon po u arrijnë tregtarët e rastit, që, si konkurentë, po fitojnë para dhe po këthehen prap?! Për këtë, kisha kërkuar nga kryetari të aktivizohet Inspeksioni e të vepron "pa pardon"? Sa u përket parkingjeve dhe vendosjes së rregullit nëpër fshatra, ky është Vendim i Inspeksionit, i aplikuar qysh para 5-6 viteve e që, mjerisht, nuk është zbatuar e që kur dikujt po u krijojet pengesa, po thirret Policia. Por, unë do të tërheq vërejtjen lidhur me faktin e sjelljes së disa biznesmenëve që, me ekspozimin e mallërave para lokaleve, po e uzurpojnë pjesën publike e që, si problem, duhet zgjidhur?

Kryetari- Lidhur me zgjerimin e rrugës në "Satdiumin e Qytetit", mendoj se duhet gatishmëria e të gjithë neve, sidomos të komunitetit jop shumicë që janë pronarë të tokave e që, ndoshta, do të ishte mirë të kyçen edhe delegatët e komunitetit jo shumicës, duke e shpallur, atë pjesë, zonë të interesit të përbashkët, përfshi edhe kompenzimin e nevojshëm ndaj pronarëve. Pra, kjo nuk paraqet problem nga ne, nëse gjendet konsenzus me pronarët e pracleve. Për mungesën e gjinekologut, disa herë, është debatuar nga ne, por edhe në nivel më të lartë dhe, më 8 Maj, do të kemi edhe përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës, që nuk do të ishte keqë, që edhe me atë rast, të parashtrohet kjo nevojë e popullatës sonë. Por, si duket, kjo çështje, po zhagitet për shkak të mungesës së mjekëve adekuat, edhe pse ne, disa herë,

kemi shpallur konkurse për mjekë, kurse për liçencat e mjekëve vendoset në nivel qendror, nga MSHëndetësisë. Lidhur me përkrahjen e klubeve, ne do të shpallim shpallje publike për të aplikuar ata, përfshi këtu edhe KF "Opoja". Ndërkaq, sa i përket mungesës së P/Urbanistik, siç e dini, me rastin e miratimit të buxhetit, për sivjet, kemi paraparë ndarjen e 40 mijë eurove dhe atë për Hartat Zonale e këtë e kemi edhe si obligim me Planin Zhvillimor dhe rekomandimet MMPlanifikimit Hapësinor, që fillimisht, t'i kemi Hartat Zonale, sepse, Plani Urbanistik, është projekt i madh e që shumica e komunave kanë filluar procedurat e tilla. Në këtë drejtim, kemi vështirësi, pasi se kjo paraqet punë të institucioneve profesionale me ekspertë të fushës, pasi se paraqet dokument të rëndësishëm të Komunës. Sa u përket planifikimeve të projekteve, nuk dëshiroj t'i politizoj gjérat, pasi se Kuvendi e ka miratuar buxhetin me Listën e projekteve të investimeve kapitale për lokalitet tona. Sa u përket emërave të delegatëve të Kuvendit të Kosovës-Adem Hoxha e Duda Bale, reth shtëpive sociale, kjo është në kompetencë të MSHMSociale dhe nuk ka qenë synimi që të promovohet ndonjë parti politike, edhe pse ashtu është interpretur, nga dikush? Sa i përket pranimit të punëtorit në ZLKKhimit, ka qenë i publikuar Konkursi, i cili nuk mund të kufizohet vetëm për banorët e Komunës sonë, por që konkurron kushdo. Nëse mendoni se ka pasur pa rregullësi, për këtë ekzistojnë procedura edhe përmes organeve gjyqësore. Sa i përket gjendjes në rrugën Glloboçicë-Krushevë, duhet ditur se disa drejtime rrugore nuk janë në kompetencën tonë por të Depratamentit për Rrugë së M/Infrastrukturës dhe ne, disa herë, i kemi ftuar përfaqësuesit e kompanisë për mirëmbajtje të rrugëve, pasi se kemi nevojë-sidomos me rastin e qëndrimit të diasporës në vendlindje dhe, vërtetë, disa rrugë tejkalojnë mundëstë tona, për intervenim. Sa u i përket dënimive që paska ngjarë në Restelicë, reth parkimit në qendër, për këtë nuk jam në dijeni, por do të interesohem me Policinë se si qëndron gjendja, edhe pse duhet ditur se Policia vepron pavarësisht dhe i ka planet e veta operative, që besoj se asgjë nuk është ndërmarr me ndonjë qëllim të pa nevojshëm? Lidhur me rrugën për "Gurin e Zi", siç e dini, ne kemi parapar buxhet të caktuar për këtë çështje, që besoj se operatori ekonomik do të përfundon sivjet këtë punë të rëndësishme sidomos për banorët e fshatrave përreth? Ndërkaq, lidhur me Apelin që tregtarët të largojnë mallërat nga trotoaret e vendet publike, mendoj se për këtë duhet të vepron Shërbimi i Inspepcionit, kurse lidhur me projektin e Ujësjellësit Qendror te ne, me këtë, po merren organet qendrore, pasi se Projekti është përrishqyrtim dhe nuk kemi shenja të qarta se kur do të ofrohet zgjidhje?! Për këtë, si duket, po kërkohen procedura të reja reth vlerësimit të Projektit e që gjendja po zhagitet e komisionet veprojnë pavarësisht dhe unë nuk mund të ndikoj, edhe pse ky Projekt ka ndikuar negativisht në funksionimin e gjithmbarshëm të Komunës sonë.

**z. Shpëtim Hajredini-** Pasi se jemi në fund të seancës, shfrytëzoj rastin që t'u uroj muajine shenjët të Ramazanit të gjithë neve dhe mbar besimtarëve të Republikës së Kosovës.

**Kryesuesi-** Nëse nuk ka edhe diçka për t'u theksuar, me kaq, përfunduan seancën e sotme të Kuvendit.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

**Kryesuesi:**

*Betim Merdiu*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality

**LISTA**

E anëtarëve-delegatëve të Kuvendit Komunal Dragash  
Çlanova-delegata Skupštine Opštine Dragash

Nr.seancës  
Br.sednice

*Toti*

Nr Br	Emri dhe mbiemri Ime i prezime	Subjekti politik Politički subjekat	Nënshkrimi Potpis
1	Betim Merdiu	PDK	<i>M. Merdiu</i>
2	Shpjetim Hajredini	PDK	<i>Shpjetim Hajredini</i>
3	Xhemile Misinaj	PDK	<i>Xhemile Misinaj</i>
4	Artan Loshaj	PDK	<i>Artan Loshaj</i>
5		PDK	-
6	Granit Rifaq	PDK	<i>Granit Rifaq</i>
7	Suada Bajrami	PDK	<i>Suada Bajrami</i>
8	Sevim Avdullahi	PDK	<i>Sevim Avdullahi</i>
9	Elira Sulejmani	PDK	<i>Elira Sulejmani</i>
10	Samidin Xheladini	LDK	<i>Samidin Xheladini</i>
11	Refik Latifi	LDK	<i>Refik Latifi</i>
12	Sefidin Mejzini	LDK	<i>Sefidin Mejzini</i>
13	Naser Myrzani	LDK	<i>Naser Myrzani</i>
14	Anjeta Skeraj	LDK	<i>Anjeta Skeraj</i>
15	Aida Misini-Halimi	LDK	<i>Aida Misini-Halimi</i>
16	Adelisa Krasniqi	LDK	<i>Adelisa Krasniqi</i>
17	Veljid Hadžisin	Vakat	<i>Veljid Hadžisin</i>
18	Munir Jonuzi	Vakat	<i>Munir Jonuzi</i>
19	Zinaida Elmazi	Vakat	<i>Zinaida Elmazi</i>
20	Seljman Osmani	JGP	<i>Seljman Osmani</i>
21	Hatidža Šeh	JGP	<i>Hatidža Šeh</i>
22	Laurat Krasniqi	LVetëvendosje	<i>Laurat Krasniqi</i>
23	Hajrudin Hodža	PGora	<i>Hajrudin Hodža</i>
24	Nexhai Isufi	Nisma	<i>Nexhai Isufi</i>
25	Zaim Hajredini	AKR	<i>Zaim Hajredini</i>
26	Florent Rufati	AAK	<i>Florent Rufati</i>
27	Redžep Kamberi	GIG	<i>Redžep Kamberi</i>

Dragash dt. 03.05.2019

Kryesuesi - Predsedavajuci